



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

PROCESVERBAL

Nr. 1181 Prot.

Tiranë, më 25.05.2021

Sot, më datë 11.05.2021, ditën e martë, ora 12.00, Këshilli i Lartë i Prokurorisë zhvilloi mbledhjen plenare jashtë radhe në platformën online, të thirrur nga Kryetari, bazuar në nenet 164 deri 167 të Ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Këshilli u mbledh në prani të anëtarëve si më poshtë:

1. Z. Gent Ibrahimi
2. Z. Alfred Balla
3. Z. Bujar Sheshi
4. Znj. Eloida Goxhi
5. Znj. Esmeralda Keshi
6. Z. Kostaq Beluri
7. Z.Moisi Duda
8. Znj. Nurihan Seiti
9. Z. Sandër Beci
10. Z. Tartar Bazaj
11. Z. Vatë Staka

Ishin ftuar për të qenë të pranishëm përfaqësues nga projektet OPDAT, EURALIUS si dhe nga Ministria e Drejtësisë.

Mbledhja u zhvillua nën drejtimin e Kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, z. Gent Ibrahimi, i cili, në zbatim të nenit 166 të Ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, pasi verifikoi pjesëmarrjen e anëtarëve, bëri hapjen e saj në kushtet e kuorumit dhe kaloi në paraqitjen e rendit të ditës.

Rendi i ditës:



1. Diskutimi/ miratimi i relacionit për caktimin e përkohshëm në pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër z. Lazër Çardaku.

2. Të tjera (pyetje, përgjigje, diskutime).

Z. Ibrahim bën me dije që kjo mbledhje jashtë radhe, ka në përmbajtje të saj vetëm një çështje, diktuar kjo nga nevoja për të zgjatur afatin e caktimit të përkohshëm të drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit, Shkodër. Ai konstaton se, pavarësisht ecurisë së mirë të procesit të emërimit përfundimtar të drejtuesve, Këshilli vijon që, pjesën më të madhe prej tyre, t'i mbajë në pozicionet përkatëse nëpërmjet caktimeve të përkohshme. Në këto kushte, Këshilli është i detyruar që të mblidhet në këtë mbledhje jashtë radhe, si pasojë e përfundimit të afatit të caktimit të përkohshëm të Drejtuesit të Prokurorisë së sipërcituar.

Z. Ibrahim pyet anëtarët, nëse kanë propozim për të shtuar çështje në rendin e ditës.

Z. Beci propozon që, në rendin e ditës të përfshihet dhe marrja e vendimit për hedhjen e shortit për caktimin e relatorit, duke argumentuar se, Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, pas procesit të verifikimit të dy kandidatëve për pozicionin e Drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Durrës, dhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit, Tiranë, përkatësisht znj. Anita Jella dhe z. Genti Xholi, sipas Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e Drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, miratuar me Vendimin nr.200, datë 23.09.2020 të KLP-së, Këshilli është i detyruar që, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë nga vendimi për kualifikimin e kandidatëve, të fillojë procedurën e ngritjes në detyrë dhe të caktojë nëpërmjet shortit relatorin, duke përzgjedhur nga mesitë e anëtarëve të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës.

Z. Ibrahim hedh në votim propozimin e parashtruar nga z. Beci.

Të gjithë janë dakord.

Rendi i ditës pasurohet me këtë çështje.

Z. Ibrahim i kërkon sektorit të dokumentacionit të seancave që të marrë masat për të siguruar mjetet nevojshme për hedhjen e shortit.

Z. Ibrahim vijon me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Diskutimi/miratimi i relacionit për caktimin e përkohshëm në pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit, Shkodër, z. Lazër Çardaku.

Z. Ibrahim fton z. Beci, të relatojë.



Z. Beci relaton se, si rezultat i procesit kalimtar të rivlerësimit, në datën 16.11.2020, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka shkarkuar nga detyra z. Brahim Dragjoshi, Drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit, Shkodër. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, ndodhur në këto kushte, për të plotësuar vendin e lirë, ka nisur menjëherë procedurën për caktimin e përkohshëm në pozicionin e Drejtuesit të kësaj Prokurorie. Me Vendimin Nr. 265, datë 17.11.2020 dhe me Vendimin Nr. 44, datë 16.02.2021 “Për caktim të përkohshëm”, Këshilli ka vendosur që z. Lazër Çardaku, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit, Shkodër, të ushtrojë funksionin e Drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, nga 17.02.2021 - 16.05.2021.

Z. Beci citon bazën ligjore në vijim: nenin 59 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 42/2 të ligjit të sipërpërmendur, nenin 3 të Rregullores “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve”, miratuar me Vendimin nr 64, datë 15.04.2019 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, e ndryshuar.

Sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, bazuar në Rregulloren e lartpërmendur, pasi bëri verifikimet përkatëse pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore, propozon që prokurori Lazër Çardaku të ushtrojë funksionin e Drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit, Shkodër, për një afat tremujor, nga 17.05.2021 – 16.08.2021, pasi plotëson kushtet e përcaktuara në ligj dhe në Rregulloren e lartpërmendur.

(Relacioni i plotë ndodhet në dosjen e depozituar në zyrën e protokollit).

Z. Ibrahim pyet anëtarët, nëse kanë pyetje apo komente.

Meqenëse nuk ka pyetje dhe komente të mëtejshme, **z. Ibrahim** vijon me leximin e projektvendimit dhe e hedh atë në votim.

Miratohet me 11 vota pro.

(Vendimi i plotë gjendet i publikuar në faqen zyrtare të Këshillit).

Z. Ibrahim vijon me pikën e dytë të rendit të ditës.

2. Caktimi me short i relatorit për fillimin e procedurës së ngritjes në detyrën e Drejtuesit, për kandidatët që kanë kaluar procesin e verifikimit.

Z. Ibrahim fton anëtarët e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës që të shkojnë në zyrën e tij, me qëllim hedhjen e shortit.

Z. Ibrahim fton stafin që të zhvillojë hedhjen shortit dhe vijon me procedurën e shortimit. Hidhet fillimisht shorti për përzgjedhjen e relatorit për Drejtuesin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit, Tiranë, z. Genti Xholi. Si rezultat i hedhjes së shortit, relator për z. Genti Xholi, përzgjidhet z. Moisi Duda.



Z. Ibrahim vijon me hedhjen e shortit për përzgjedhjen e relatorit tjetër, për Drejtuesin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Durrës, znj. Anita Jella. Relator përzgjidhet anëtari tjetër i Komisionit për Zhvillimin e Karrierës, z. Vatë Staka.

Z. Ibrahim fton anëtarët e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës, që të rikthehen në zyrat e tyre dhe më pas vijon me leximin e projektvendimit.

Z. Ibrahim pyet anëtarët, nëse kanë pyetje apo komente.

Meqenëse nuk ka pyetje dhe komente të mëtejshme, **z. Ibrahim** vijon me leximin e projektvendimit dhe e hedh atë në votim.

Miratohet me 11 vota pro.

(Vendimi i plotë gjendet i publikuar në faqen zyrtare të Këshillit).

Z. Ibrahim falënderon anëtarët për diskutimet e tyre dhe, në përfundim, duke mos patur pika të tjera për diskutim, e deklaroi mbledhjen të mbyllur.

Mbajtësi i procesverbalit

Sonila Çeliku



KRYETARI

Gent Ibrahim

Shënim 1:

Në këtë procesverbal janë/nuk janë vënë në dukje pasaktësitë e mundshme, të konstatuara nga anëtarët e KLP-së.

Pasaktësitë e vërejtura janë reflektuar me urdhër të kryetarit Nr. ___ Datë ___ 2021/me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë Nr. ___ datë ___ (bashkëlidhur kopjet e dokumenteve).

Procesverbali i mësipërm u miratua në mbledhjen e radhës të KLP-së, datë 25/05/2021

Procesverbali të arkivohet.

PËRGJEGJËSI I SEKTORIT TË SHËRBIMEVE ADMINISTRATIVE

Frederik Sulisufi